



# POLITIKA E SHPËRNDARJES SË INFORMACIONIT STATISTIKOR

2025

**TABELA E PËRMBAJTJES**

<b>Hyrje .....</b>	<b>3</b>
<b>Parimet e përgjithshme të shpërndarjes së statistikave zyrtare.....</b>	<b>4</b>
<b>    Politikat dhe proceset e shpërndarjes së statistikave zyrtare .....</b>	<b>6</b>
Datat e publikimit.....	6
Rishikime .....	7
Trajtimi i gabimit .....	8
Keqinterpretimi, keqpërdorimi dhe kritikat ndaj statistikave zyrtare .....	11
<b>    Mbrojtja e konfidencialitetit statistikor dhe politika e privatësisë .....</b>	<b>12</b>
<b>    E drejta e autorit.....</b>	<b>12</b>
<b>    Referuar burimit të të dhënave .....</b>	<b>13</b>
<b>    Palët e interesuara të statistikave .....</b>	<b>13</b>
Përdoruesit .....	14
Prodhuesit .....	14
Palët e interesuara të brendshme.....	15
Reagimi dhe matja e rezultateve .....	16
<b>    Produkte dhe Shërbime të ofruara .....</b>	<b>16</b>
Të dhënat themelore.....	16
Produkte standarde dhe shërbimet .....	16
Informacione të hollësishme.....	17
Shërbimet e ofruara nga INSTAT.....	18
<b>    Shtyllat e komunikimit për promovimin e statistikave zyrtare .....</b>	<b>19</b>
Strategjia është ndërtuar në bazë të 6 shtyllave të komunikimit .....	19
Publikime.....	20
<b>    Marrëdhëniet me Media dhe Publiciteti.....</b>	<b>20</b>
Media Dixhitale .....	23
Angazhimi i palëve të interesuara.....	23
<b>Aneks I - Rregulla për citimin dhe përdorimin korrekt të të dhënave statistikore nga INSTAT .</b>	<b>23</b>

## POLITIKA E SHPËRNDARJES SË INFORMACIONIT STATISTIKOR

### Hyrje

Roli i INSTAT-it, si koordinator zyrtar i Sistemit Kombëtar Statistikor, bazuar në Ligjin Nr. 17 datë 05.04.2018 "Për Statistikat Zyrtare", është të prodhojë statistika zyrtare, të mbledhë, përpunojë, analizojë, publikojë dhe arkivojë të dhëna. INSTAT-i është person juridik publik i pavarur dhe organizohet në nivel qendror. Zyrat rajonale statistikore, të krijuara në nivelin vendor, funksionojnë brenda strukturës organizative të INSTAT-it dhe janë në varësi të tij.

Sic parashikohet në Ligjin për "Statistikat Zyrtare", Programi i Statistikave Zyrtare 2022- 2026, përbën bazën e objektivave dhe misionit të INSTAT në vitet e ardhshme. Është detyrë e Drejtorisë së Komunikimit dhe Publikimeve të identifikojë nevojat e përdoruesve dhe të shpërndajë statistika zyrtare. Kjo detyrë përmbushet në bashkëpunim me drejtori të tjera të INSTAT. Për këtë qëllim, aktivitetet e shpërndarjes janë përcaktuar, përfshirë shpërndarjen e informacionit statistikor, anketën e kënaqësisë së përdoruesve, modelimin e produktit, politikën e çmimeve, zgjedhjen e kanaleve të shpërndarjes dhe metodat mbështetëse. Të gjitha këto aktivitete ndjekin parimet e kësaj politike të shpërndarjes.

### Këshilli i Statistikave

Këshilli i Statistikave është organi përgjegjës për këshillimin dhe përkrahjen e INSTAT-it në rolin e tij për zbatimin e veprimtarive statistikore të ofruara nga Programi i Statistikave Zyrtare. Ky organ përbëhet nga 11 anëtarë që përfaqësojnë përdorues nga agjencitë statistikore, bota akademike, shoqëria civile, media dhe përdorues të tjerë kryesorë. Qëllimi i Këshillit të Statistikave është të sigurojë, duke dhënë këshilla, përcjelljen e mendimeve/opinioneve gjatë proceseve të planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve statistikore nga Sistemi Kombëtar Statistikor. Anëtarët e Këshillit publikohen në faqen zyrtare të INSTAT.

Këshilli i Statistikave mbikëqyr INSTAT-in dhe jep mendim për Projekt-Programin e Statistikave Zyrtare, projektplanin vjetor për zbatimin e tij si dhe shqyrton raportet zyrtare për ecurinë e veprimtarisë statistikore në vend. Raporti zyrtar duhet të mbulojë në mënyrë të përsosur detyrat e të gjithë programit të punës statistikore, me fjalë të tjera, duke përfshirë detyrat e kryera nga Autoritetet e tjera Kombëtare për Prodhimin Statistikor. Banka e Shqipërisë publikon reportin e saj, duke përfshirë një raport mbi aktivitetet e saj statistikore, e cila do të jetë pjesë përbërëse e rapportit vjetor të veprimtarisë së Sistemit Kombëtar Statistikor.

Politika e shpërndarjes së statistikave zyrtare në INSTAT bazohet në Ligjin Nr. 17 datë 05.04.2018 për "Statistikat Zyrtare", Programin e Statistikave Zyrtare, Planin Vjetor për zbatimin e tij, Rregulloren (KE) Nr. 223/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi Statistikat Evropiane, dhe Kodin e Praktikës të Statistikave Evropiane.

## POLITIKA E SHPËRNDARJES SË INFORMACIONIT STATISTIKOR

### Parimet e përgjithshme të shpërndarjes së statistikave zyrtare

Publikimi dhe shpërndarja e informacionit statistikor në INSTAT është e centralizuar dhe koordinuar nga Drejtoria e Komunikimit dhe Publikimeve. Shpërndarje nënkupton që statistikat dhe analizat statistikore të janë të arritshme për përdoruesit.

**Akses i Barabartë** – INSTAT-i njofton paraprakisht datat e shpërndarjes së statistikave zyrtare në Kalendarin e tij vjetor. Të gjithë kategoritë e përdoruesve, përfshirë Eurostatin, autoritetet shtetërore dhe media, kanë akses në të njëjtën kohë në statistikat e publikuara.

**Të paanshëm, objektivë dhe transparentë** - Shpërndarja e informacionit statistikor zbatohet nga INSTAT-i. Neni 4 i Ligjit “Për Statistikat Zyrtare” shprehimisht përcakton “paanshmërinë” si një parim udhëzues për organizimin dhe zbatimin e Programit Statistikor. Në statistikat zyrtare nuk përfshihet asnjë koment politik apo komente të autoriteteve qeveritare. Është përgatitur dhe publikuar në faqen zyrtare elektronike të INSTAT “Politika e Trajtit të Gabimit”, së bashku me “Politikën e Rishikimit” dhe “Angazhimi për Cilësinë”.

**Publikimi i njëkohshëm** - Statistikat zyrtare publikohen në databazën statistikore. Në rast se një njoftim për shtyp publikohet sipas datës së përcaktuar, në të njëjtën kohë publikohen të dhënat statistikore që përditësohen në databazën statistikore.

**Të dhënat identike në të gjitha burimet** - Për të garantuar të dhëna identike në të gjitha burimet, njoftimet për shtyp, botimet, etj., janë të gjitha të disponueshme dhe të përdorshme nga databaza statistikore.

**Shpërndarje me metadata** - Statistikat zyrtare gjithmonë duhen shpërndarë me metadata dhe me shpjegime shumë të qarta, për të shmangur keqinterpretimet dhe keqpërdorimet.

**Konfidencialiteti dhe gabimi njerëzor** - INSTAT mbron konfidencialitetin e të dhënavë. I gjithë personeli ka nënshkruar marrëveshje konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënavë realizohet përmes një kornize të unifikuar për të kontrolluar nivelet e aksesimit.

### Politika dhe udhëzimet e shpërndarjes së informacionit

**Politikat e çmimeve dhe ato pa pagesë** - Sipas Ligjit “Për Statistikat Zyrtare”, neni 29, statistikat zyrtare ofrohen pa pagesë për publikun dhe çdokush mund t'i përdorë përmes faqes së internetit.

Analizimi dhe përpunimi i të dhënavë të kërkua nga përdoruesit nuk lejohen, as kundrejt një pagesë, përveç rasteve të parashikuara në legjislacionin për statistikat zyrtare, kur INSTAT u ofron shërbime të tretëve, kundrejt tarifave të paracaktuara. Publikimet fizike u shpërndahen pajtimtarëve të INSTAT pa pagesë.

## Angazhimi për Cilësinë

Parimet e statistikat zyrtare për cilësinë statistikore të pranuara ndërkombëtarisht , ndiqen edhe nga INSTAT-i. Sipas nenit 5 të ligjit “Për Statistikat Zyrtare”, ku kërkohet që prodhimi statistikor të jetë në përputhje me një seri kriteresh të cilësisë që korrespondojnë me standardet evropiane. INSTAT-i i kushton një vëmendje të madhe menaxhimit të cilësisë Në të gjitha fazat e prodhimit statistikor.

Pranë Drejtorisë së TI-së aktualisht operon Njësia e Cilësisë dhe Metadatës si edhe e Menaxhimit të Bazës së të Dhënave dhe Aksesit në Mikrodata. Prej vitit 2017, INSTAT-i zbaton gjithashtu standardet e cilësisë bazuar në SIMS, siç janë raportet e cilësisë për përdoruesit ESMS (Struktura e Metadatës Euro SDMX) dhe raportet e cilësisë për prodhuesit ESQRS (Struktura e Raportit Standard të Cilësisë ESS). Raportet e cilësisë janë në dispozicion të publikut dhe të publikuara rregullisht në faqen zyrtare të internetit. Komunikimi i rregullt për nivelin e cilësisë në të gjitha fushat e statistikave është në proces të vazhdueshëm për përmirësim të mëtejshëm.

Treguesit e cilësisë, si më poshtë:

- **Rëndësia:** Për të vlerësuar shkallën në të cilën statistikat plotësojnë nevojat aktuale dhe potenciale të përdoruesve, INSTAT realizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve. Proseset tjetra, të tillë si kërkesa për menaxhimin e informacionit, analiza e përdoruesve të faqes së internetit dhe Facebook-ut, janë krijuar për të monitoruar dhe për tu konsultuar me përdoruesit.
- **Saktësia dhe besueshmëria:** I referohet vlerësimeve më të përafërtë ndaj vlerave reale të panjohura. Për këtë INSTAT vlerëson dhe vërteton rregullisht burimin e të dhënave, rezultatet e ndërmjetme dhe rezultatet statistikore.
- **Afati dhe përpikmëria:** INSTAT-i do të duhet të përbushë standardet evropiane dhe ndërkombëtare duke patur parasysh periudhën midis disponueshmërisë së informacionit dhe ngjarjes apo fenomenit që po përshkruhet, dhe vonesës midis datës së publikimit të të dhënave dhe datës së synuar (data në të cilën të dhënat duhej të ishin shpërndarë). Kalendari vjetor publikohet në faqen zyrtare elektronike të INSTAT-it dhe divergjencat nga objektivi identifikohen dhe monitorohen rregullisht, si dhe publikohen paraprakisht.
- **Kalendari i publikimeve publikohet në faqen zyrtare të INSTAT-it brenda datës 20 Dhjetor, pasi të ketë marrë datat e publikimeve nga prodhuesit e tjera, brenda Sistemit Kombëtar Statistikor.**
- **Qasja dhe Qartësia:** I referohet kushteve dhe modalitetet e mund të marrin, përdorin dhe interpretojnë të dhëna. Faqja aktuale zyrtare, e lançuar në vitin 2017, siguron një akses shumë të avancuar në përputhje me standardet e Eurostatit, dhe është e disponueshme në dy gjuhë. Takime me palë të interesuara për të shpjeguar se si t'i interpretojnë statistikat janë të planifikuara në Planin Operacional, përmes një kalendari vjetor të detajuar, të miratuar nga Bordi Drejtues. Informacioni statistikor publikohet gjithmonë me

## POLITIKA E SHPËRNDARJES SË INFORMACIONIT STATISTIKOR

informacionin dhe përshkrimin e qartë mbi metodologjinë e proceseve statistikore, përfshirë përdorimin e të dhënave administrative.

- **Koheranca dhe Krahasueshmëria:** Duke iu referuar përshtatjes së të dhënave për të qenë besueshmërisht të kombinuara në mënyra të ndryshme dhe për përdorime të ndryshme, dhe matjes së ndikimit të ndryshimeve në konceptet e aplikuara statistikore, mjetet e matjes dhe procedurat ku statistikat krahasohen midis zonave gjeografike, fushat sektoriale, duhet të jenë në përputhje me standartet e zakonshme.
- **Përkatësia,** që do të thotë se mbledhja e të dhënave, duhet të kufizohet për aq sa është e nevojshme për të arritur rezultatin e kërkuar.
- **Transparenca,** e cila i referohet të drejtës së të anketuarve të kenë informacion mbi bazën ligjore, qëllimin për të cilin kërkohen të dhënrat dhe masat mbrojtëse të miratuara.

### [Politikat dhe proceset e shpërndarjes së statistikave zyrtare](#)

#### [Datat e publikimit](#)

Datat e publikimit të statistikave zyrtare shfaqet në Kalendarin Vjetor të Publikimit, i cili vihet në dispozicion për publikun, në faqen zyrtare elektronike. Kalendar Vjetor i Publikimit duhet të jetë i disponueshëm para përfundimit të vitit, brenda datës 20 Dhjetor. Sipas ligjit për statistikat zyrtare, autoritetet e tjera publike, të autorizuara të prodrojnë dhe të publikojnë statistika zyrtare, janë të detyruara të botojnë kalendarin e tyre brenda datës 20 Dhjetor. Statistikat zyrtare vihen në dispozicion në faqen e internetit në orën 11:00, sipas datës së caktuar në kalendar. Të dhënrat që publikohen vetëm në internet (për shembull tabelat e paracaktuara) përditësohen automatikisht në orën 11:00 të parades, në datën e përcaktuar në kalendar, duke përdorur të dhënrat nga baza e të dhënave statistikore. Kopjet në letër të botimeve vihen në dispozicion të përdoruesve nga ora 11:00 e parades.

Data e publikimit, për botime të jashtëzakonshme, nuk njoftohet paraprakisht në kalendarin e publikimeve, në rastet kur publikimet nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e statistikave, nëse ato kanë të bëjnë me komunikim kritik (për shembull, në rast të keqpërdorimit të statistikave zyrtare) ose në rastet kur lidhen me ngjarje të veçanta (p.sh. misione nga organizata të tjera statistikore, etj). Po ashtu, kur këto botime nuk mund të publikohen në kohën e përcaktuar (11:00 e parades), që është koha optimale e publikimit, zgjidhet një kohë në varësi të përbajtjes së botimit. Ndryshimi i datës së publikimit lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme. Nëse ndodh një gjë e tillë për nevoja të pashmangshme, ose nëse një festë zyrtare bie në atë datë, kreu i sektorit përgjegjës dërgon një njoftim me shkrim, shoqëruar me një shpjegim, drejtorit të Drejtorisë së Komunikimit dhe Publikimeve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së publikimit. Kreu i DKP-së sigurohet që Kalandari i Publikimit të ndryshohet dhe që përdoruesit të njoftohen, nëse është e nevojshme. Nëse ndryshimi ndodh ditën e publikimit, atëherë data e rishikuar e botimit publikohet dhe shfaqet në kalendarin e publikimeve në faqen

## POLITIKA E SHPËRNDARJES SË INFORMACIONIT STATISTIKOR

e internetit përmes një shënimis, duke e mbajtur të dukshme edhe datën origjinale të botimit. Përdoruesit njoftohen për ndryshimet në ditët e njoftimeve për shtyp apo të botimeve, sipas nevojës.

### Rishikimet

Rishikimet e të dhënave bëhen sipas procedurave të rregulluara dhe në mënyrë transparente, të udhëhequra nga Politika Statistikore e Rishikimit. Ekzistojnë dy lloje të rishikimeve siç përcaktohen më poshtë:

#### 1. Rishikimet e planifikuara:

- Rishikimi rutinor:** një ndryshim i tillë në të dhënat e publikuara, i cili vjen nga procesi i rregullt i prodhimit të të dhënave (p.sh. zëvendësimi i vlerës së vlerësuar të të dhënave që mungonin, me të rejet; zëvendësimi i të dhënave paraprake me të dhënat përfundimtare; Rregullimet nga efektet sezionale; konsolidimi i të dhënave (krahasimi).
- Rishikim më i madh:** modifikime thelbësore, rishikime në të dhënat e publikuara tashmë, për shkak të ndryshimeve në bazën ligjore, klasifikimeve dhe metodologjive në Politikën e Trajtitimit të Gabimeve. Rishikime retrospektive të serive kohore, bazuar në censem që zbatohen çdo dhjetë vjet; ndryshim i periudhës bazë, si zëvendësim i faktorëve të peshimit në indekse.

#### 2. Rishikimi i paplanifikuar:

- Rishikimi i pa njoftuar më parë i të dhënave,** për të cilin lind nevoja nga një ngjarje e paparashikuar (p.sh. gabime në mbledhjen e të dhënave, gabime në përpunimin e të dhënave, probleme teknike, faktorë natyrorë).

### Shpallja e Rishikimeve

Përdoruesit duhet të njoftohen njëkohësisht për rishikimet e planifikuara dhe publikimin e rezultateve. Informacioni në lidhje me publikimin e të dhënave të rishikuara është gjithashtu i përfshirë në njoftimet përkatëse për shtyp. Në rast të rishikimeve të parregullta, data e publikimit të të dhënave të rishikuara shpallet në kalendarin e publikimeve, tre muaj përpara. Në rast të rishikimeve të rregullta (publikimi i të dhënave paraprake dhe përfundimtare), të dy datat e publikimit përfshihen në kalendarin e publikimeve. Gjithashtu, informacioni mbi kryerjen e rishikimeve dhe datën e publikimit të rezultateve jepet në fund të njoftimeve përkatëse për shtyp, të paktën tre muaj para publikimit të të dhënave të rishikuara. Në rast të rishikimeve të mëdha (psh. PBB), një njoftim me shkrim u dërgohet përdoruesve përkatës, të paktën tre muaj para publikimit të të dhënave të rishikuara. Në ditën e publikimit të të dhënave të rishikuara, një përbledhje e hollësishme publikohet gjithashtu në webfaqe (përfshirë arsyet dhe ndikimin e rishikimit) dhe organizohen njoftime për përdoruesit, nëse është e nevojshme.

### **Publikimi i të dhënave paraprake dhe përfundimtare**

Në publikimet statistikore të INSTAT, informacioni në lidhje me statusin e vlerësimit të të dhënave jepet në pjesën narrative, d.m.th. nëse të dhënat janë paraprake apo përfundimtare. Në botimet elektronike, ky lloj informacioni vendoset në fund të tabelave në formatin vijues: Të dhënat përfundimtare; Të dhëna gjysmë-përfundimtare; Të dhënat paraprake.

Në Botimin e Parë, në hapësirën kushtuar shënimave metodologjike jepet informacioni se kur të dhënat e ardhshme do të publikohen si gjysmëfinale ose përfundimtare. INSTAT publikon politikën dhe praktikën e rishikimit të secilës statistikë të specializuar, në dokumentacionin metodologjik në faqen zyrtare elektronike. Në dokumentacionin metodologjik të statistikave të specifike, INSTAT boton skedulimin e rishikimeve, shpeshtësinë e rishikimeve dhe vitet e përfshira nga rishikimi.

### **Trajtimi i gabimit**

Politika e trajtimit të gabimeve ekziston për të siguruar një kornizë të përbashkët përmes menaxhimin e gabimeve në të gjithë fushat e prodhimit statistikor, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së proceseve statistikore, produkteve dhe shërbimeve, si dhe imazhin e INSTAT-it. Politika e Trajtimit të Gabimeve është një komponente e Parimet e Rishikimit të të Dhënave Statistikore, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane, parimet e Paanshmërisë dhe objektivitetit dhe Procedurat e duhura statistikore.

### **Njoftimi i gabimeve**

Gabimet e identikuara ndahen në llojet e mëposhtme:

**1. Gabime me një ndikim të parëndësishëm:** të dhëna të pasakta që nuk ndryshojnë të dhënat dhe informacionin e botuar ("gabim"). Ato përfshijnë, përmes shembullit, gabime gramatikore, ose drejtshkrimore, linqe të paplota apo të papërditësuara, të cilat nuk ndikojnë në interpretimin e trendit nga përdoruesit.

**2. Gabime me ndikim të vogël:** tabela të gabuara, tekste ose të dhënat e grafikut:

- rëndësia e të cilës është aq e vogël sa që përbajtja e informacionit mbetet e pandryshuar (pavarësisht nga niveli i aggregimit) ose
- që ndodhin në çdo nivel aggregimi dhe rëndësia e të cilave është e madhe dhe mjaftueshme përmes përbajtjenës së informacionit, por që nuk është me interes për publikun.

**3. Gabime me një shkallë të lartë ndikimi/ kritike:** tabela, tekste ose grafik të dhënash të pasakta të cilat:

- ndodhin në çdo nivel aggregimi, rëndësia e të cilave është e madhe dhe mjaftueshme përmes përbajtjenës së informacionit dhe janë me interes për publikun ose
- kanë pasoja të konsiderueshme ekonomike ose

## POLITIKA E SHPËRNDARJES SË INFORMACIONIT STATISTIKOR

c. përbëjnë një shkelje të mbrojtjes dhe konfidencialitetit të të dhënave.

Në të gjitha rastet, drejtori i një drejtorie që prodhon statistika, ku edhe u krijuar gabimi, informon drejtuesin e DKP-së, në mënyrë që ata të jenë të vetëdijishëm për gabimin e shkaktuar që të jenë aftë t'u përgjigjen komenteve të përdoruesve.

Përgjegjësi i sektorit, së bashku me drejtorin e një drejtorie dhe me personin përgjegjës për punën, përcakton llojin e gabimit në përputhje me kategoritë e përcaktuara më sipër. Në çdo botim të shtypur përmendet, që në rast të zbulimit të gabimit, një gabim do të publikohet në faqen e internetit të INSTAT.

**Gabimet me një ndikim të parëndësishëm / të papërfillshëm** korrigohen pa përmendur në njoftimet për shtyp, botimet, bazat e të dhënave në internet ose në faqen zyrtare elektronike. Nuk ka veprim të njoftimit aktiv për përdoruesit e njohur. Në rast të njoftimeve për shtyp, gabimi do të korrigohet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe versioni i korriguar do të publikohet në faqen e internetit të INSTAT. Në rast të botimeve të shtypura dhe elektronike, gabimi do të korrigohet dhe prezantohet numrin tjetër të botimit. Në rast të të dhënave të publikuara në bazat e të dhënave në internet, të dhënat e gabuara zëvendësohen nga ato të sakta, sa më shpejt të jetë e mundur. Në rast të të dhënave dhe informacionit të publikuar në faqen e internetit, gabimi zakonisht korrigohet në rishikimin tjetër të faqes përkatëse.

**Gabimet me një shkallë të vogël të rëndësisë** korrigohen në njoftimet për shtyp, në versionin elektronik të botimeve, në bazat e të dhënave në internet dhe në faqen e internetit. Në rast të njoftimeve për shtyp, një shënim mbi korrigjimin do të përfshihet nën titull, të tilla si "Versioni i korriguar i ... (përmendet treguesi)", të dhënat e korriguara do të shkruhen me shkronja të zeza dhe një shënim në fund të faqes shënon se të dhënat me shkronja të zeza paraqet një korrigjim të të dhënave të botuara më parë, duke përmendur numrin dhe datën e njoftimit për shtyp. Njoftimi i ri për shtyp do të postohet në faqe dhe do të zëvendësojë atë të mëparshmin. Në rast të botimeve të shtypura, asnjë botim i ri i korriguar nuk do të shtypet, por gabimi në të shkruar do të botohet në faqen e internetit të INSTAT.

Në rast të botimeve elektronike, versioni i pasaktë do të zëvendësohet sa më shpejt të jetë e mundur, duke përfshirë skedarët e bashkangjitur të Excel-it. Një shënim mbi të dhënat dhe / ose informacionin e korriguar në versionin elektronik do të përfshihet në faqen e parë. Në rast se botimi, sipas katalogut të botimeve, lëshohet si në format elektronik ashtu edhe në atë të shtypur, shënim i do t'i referohet edhe gabimeve në botimin e shtypur. Në rast të të dhënave të botuara në bazat e të dhënave në internet, grupet e gabuara të të dhënave do të zëvendësohen nga ato të korriguara dhe hapësira e kushtuar njoftimeve do të përfshijë një shënim mbi të dhënat e korriguara.

Në rast të të dhënave dhe informacioneve të publikuara në faqen e internetit, gabimet do të korrigohen dhe faqja përkatëse do të zëvendësohet sa më shpejt që të jetë e mundur.

**Në rast të gabimeve me shkallë të madhe të ndikimit / kritik**, botimet dhe njoftimet për shtyp tërhiqen nga faqja zyrtare elektronike dhe korrigjohen sa më shpejt që të jetë e mundur. Gabimet serioze të përmbajtjes që u zbuluan në një formë të shpërndarjes, rëndësia e të cilave është ulur ndjeshëm, për shkak të vonesës në kohë, krahasuar me periudhën e referencës, përjashtohen nga ky rregull. Këto gabime të mëvonshme i nënshtrohen kritereve të korrigjimit të gabimeve me një shkallë të një rëndësie të vogël. Në rast gabimesh me një shkallë të madhe ndikimi / kritike, do të këshillohen personat e mëposhtëm: përgjegjësi i sektorit në fjalë, drejtori i një drejtorie që prodhon statistika dhe drejtori i përgjithshëm i INSTAT.

Njësia përgjegjëse prodhon urgjentisht një version të korriguar të njoftimit për shtyp dhe / ose të botimit dhe përpilon si më poshtë:

- një dokument që do të publikohet në faqen e internetit të INSTAT, duke iu referuar gabimit të zbuluar, shkakun e tij, mënyrën e korrigjimit dhe produktet që do të korrigjohen (njoftimi për shtyp, botimi elektronik dhe i shtypur, baza e të dhënavë, etj.);
- një raport i brendshëm që tregon shkakun e gabimit, mënyrën e zgjidhjes së tij, datën e korrigjimit dhe masat për të parandaluar shfaqjen e gabimeve të ngjashme në të ardhmen. Drejtoria e Komunikimit dhe Publikimeve, me mbështetjen e drejtorisë që prodhon statistika, poston dokumentin e përmendur më lart në faqen e internetit të INSTAT. Përmendja e korrigjimit duhet të jetë e dukshme, mundësish në faqen kryesore të internetit të INSTAT-it.

Drejtoria e Komunikimit dhe Publikimeve këshillon përdoruesit / abonuesit e rëndësishëm për gabimin. Përveç këtyre rregullave të përgjithshme, në varësi të llojit të produktit të botuar, zbatohen një sërë rregullash specifike. Në rast të njoftimeve për shtyp, një shënim mbi korrigjimin do të përfshihet nën titull, të tillë si "Versioni i korriguar i ... (duke përmendur treguesin)", të dhënat e korrigjuara do të shkruhen me shkronja të zeza dhe një shënim në fund të faqes do të shpjegojë se të dhënat me shkronja të zeza paraqesin një korrigim të të dhënavë të botuara më parë, duke përmendur numrin dhe datën e njoftimit për shtyp. Njoftimi i ri për shtyp do të postohet në faqen zyrtare dhe do të zëvendësojë atë të mëparshmin, duke ia përcjellë përdoruesve përmes të njëjtë kanal si ai i gabuari.

Në rast të botimeve të shtypura, nëse botimi rishtypet, gabimi korrigjohet dhe shoqërohet me një shënim për korrigjimin e vendosur në një vend përkatës, zakonisht në të njëjtën faqe ku është korriguar gabimi. Nëse botimi nuk rishtypet, një listë me gabimet e korrigjuara do t'i shtohet botimit që nuk është shpërndarë ende dhe po e njëjta listë do të botohet edhe në faqen e internetit.

Vendimi për ribotim do të bazohet në një analizë të kostos dhe përfitimit.

Në rast të botimeve elektronike, versioni i pasaktë zëvendësohet sa më shpejt që të jetë e mundur, zakonisht të njëjtën ditë, duke përfshirë edhe tabelat Excel. Një shënim mbi të dhënat dhe/ose informacionin e korriguar në versionin elektronik do të përfshihet në faqen e parë

## POLITIKA E SHPËRNDARJES SË INFORMACIONIT STATISTIKOR

dhe, nëse është e nevojshme, shkakun e gabimit. Përshkrimi i përbledhur i botimit elektronik në faqen e internetit do të përfshijë një referencë për gabimin, korrigjin dhe datën e korrigjimit.

Në rast se botimi, sipas kalendarit të publikimeve, shpërndahet në format elektronik dhe të shtypur, por botimi nuk është rishtypur, shënim gjithashtu duhet t'i referohet gabimeve në botimin e shtypur. Në rast të dhënavë të botuara në bazën e të dhënavës në internet, të dhënat e gabuara do të zëvendësohen nga ato të korrigjuara dhe hapësira e dedikuar për njoftimet do të përfshijë, nëse është e nevojshme, një shënim mbi të dhënat e korrigjuara.

Në rast të dhënavës dhe informacioneve të publikuara në faqen e internetit, gabimet do të korrigjohen dhe faqja përkatëse do të zëvendësohet brenda maksimumit 2 ditëve nga zbulimi i gabimit. Në varësi të zgjidhjes teknike që do të bëhet, një shënim mbi të dhënat / informacionin e korriguar duhet të përfshihet dhe, nëse është e nevojshme, shkaqet e gabimit. Gabimet që përbëjnë shkeljen e mbrojtjes së dhënavës dhe konfidentialitetit konsiderohen gabime të mëdha me ndikim të lartë/ kritik.

Si korrigimi dhe komunikimi i gabimeve të tilla vendosen, në përputhje me legjislacionin për statistikat zyrtare, së bashku me dokumente të tjera specifike legjislative për mbrojtjen e të dhënavës personale dhe konfidentialitetin. Përfshirja e shefit të sektorit, e drejtorit të drejtorisë përgjegjëse, drejtorit të përgjithshëm duhet të menaxhojë këto lloj gabimesh.

### Keqinterpretimi, keqpërdorimi dhe kritikimi i statistikave zyrtare

**Komentet rreth keqinterpretimeve, keqpërdorimeve dhe kritikave**, kërkojnë që INSTAT-i të ndihmojë përdoruesit me “një interpretim korrekt të dhënavës mbi statistikat zyrtare”.

Interpretimi i gabuar i statistikave zyrtare do të thotë që, për shkak të mungesës së njojurive të mira të fushës, treguesit e saktë statistikorë vendosen në një kontekst ku do të ishte më mirë të përdoreshin treguesit të tjerë statistikorë ose të shtohet diçka në parametrat e përdorur, në mënyrë që të nxjerr ndonjë përfundim.

Keqpërdorimi i statistikave zyrtare nënkuption nxjerrjen e konkluzioneve arbitrale, në bazë të dhënavës së sakta ose të pasakta.

Nëse statistikat zyrtare janë keqinterpretuar ose keqpërdorur, Drejtoria e Komunikimit dhe Publikimeve (ose përfaqësuesi i departamentit përkatës) duhet të kontaktojë përdoruesin në fjalë, t'i térheqë vëmendje për keqinterpretimin ose keqpërdorimin e dhënavës dhe t'i sigurojë informacionin e saktë. Në rast të keqinterpretimit ose keqpërdorimit në media, DKP duhet të koordinojë me redaktorin e medias nëse një njoftim i gabimit, një artikull shpjegues i shkruar nga INSTAT-i ose një intervistë me një përfaqësues të INSTAT-it, duhet të publikohet nga kanalin mediatik për dhënavët keqinterpretimin apo keqpërdorimin.

Nëse është e nevojshme, INSTAT-i mund të publikojë shpjegimin në formën e një njoftimi përshtyp. Në rast të kritikave të statistikave zyrtare, INSTAT-i duhet të veprojë në të njëjtën mënyrë si në rast të keqinterpretimit dhe keqpërdorimit të statistikave.

## POLITIKA E SHPËRNDARJES SË INFORMACIONIT STATISTIKOR

### Mbrojtja e konfidencialitetit statistikor dhe politika e privatësisë

Konfidencialiteti statistikor garantohet nga nen 31 i Ligjit Nr. 17, datë 05.04.2018 "Për statistikat zyrtare". Të dhënat e mbledhura, të përpunuara dhe të ruajtura për prodhimin e statistikave zyrtare do të trajtohen nga INSTAT, agjencitë statistikore dhe çdo organizatë ose person i mandatuar nga INSTAT, si rreptësish Konfidenciale në rastet kur lejohet identifikimi i njësive statistikore, direkt ose indirekt, duke zbuluar kështu informacione individuale që nuk janë bërë tashmë publike për arsyet e tjera.

Në përputhje me parimin e konfidencialitetit statistikor, të dhënat për të anketuarit duhet të përdoren vetëm për qëllime statistikore, që do të thotë se të dhënat nuk mund të përdoren për qëllime administrative, ligjore, tativore ose monitoruese. Ligji ndalon shpërndarjen e statistikave jashtë këtyre qëllimeve. Parimi i konfidencialitetit statistikor zbatohet gjithashtu për të dhënat e përgjithshme, d.m.th. rezultatet nuk merren nga institucionet qeveritare para datës së publikimit, të specifikuar në kalendarin e publikimeve, pasi INSTAT-it i kërkojë të sigurojë qasje të barabartë në statistikat zyrtare për të gjithë përdoruesit.

Institucioni/personi që dëshiron të përdorë të dhënat për qëllime shkencore duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim në INSTAT, duke kërkuar akses në të dhëna anonime, në përputhje me Rregulloren e Aksesit në të Dhënat Mikro

([http://www.instat.gov.al/media/9946/rregulllore\\_e\\_aksesit\\_n%C3%AB\\_t%C3%AB\\_dh%C3%ABnat\\_mikro\\_.pdf](http://www.instat.gov.al/media/9946/rregulllore_e_aksesit_n%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnat_mikro_.pdf)). Aplikanti njoftohet për miratimin ose refuzimin e aplikimit brenda 15 ditëve pune, nga marrja e aplikimit duke kërkuar informacionin specifik.

Të dhënat personale merren gjatë mbledhjes së të dhënave për prodhimin e statistikave zyrtare. Përveç kësaj, INSTAT-i mund të marrë të dhëna personale përmes kërkesave ose urdhreve për informacion, gjatë kryerjes së vrojtimeve të klientëve, gjatë rekrutimit, etj. Ruajtja e privatësisë është e publikuar në faqen e internetit të INSTAT, ku përshkruhet se si përdoren dhe mbrohen informacionet e mbledhura (<http://instat.gov.al/al/rreth-nesh/ne-jemi-instat/ruajtja-e-privat%C3%ABsis%C3%AB/>).

Marrëveshjet e konfidencialitetit janë të detyrueshme për tu nënshkruar nga i gjithë stafi dhe palët e jashtme që kryejnë aktivitete në emër të INSTAT-it. Në rast modifikimi, marrëveshjet duhet të përditësohen dhe nënshkruhen përsëri nga i gjithë stafi ose palët e interesuara. Të gjitha palët që nënshkruajnë një marrëveshje konfidencialiteti janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin e besueshmërisë edhe pas përfundimit të funksionit të tyre të punës. Dënimet për mosrespektim të detyrimeve të përcaktuara parashikohen në nenin 38 të Ligjit "Për Statistikat Zyrtare".

### E drejta e autorit

I gjithë rezultati statistikor është një objekt i të drejtës së autorit dhe mbrohet nga legjislacioni shqiptar. Megjithëse e drejta e autorit në një vepër lind në momentin e krijimit të veprës nga autori dhe nuk kërkohet asnjë njoftim i veçantë, të gjitha botimet statistikore duhet të

## POLITIKA E SHPËRNDARJES SË INFORMACIONIT STATISTIKOR

përfshijnë shënimin “*Copyright © Instituti i Statistikave - Tiranë / Të gjitha të drejtat e rezervuara INSTAT*” dhe gjithashtu shënimin “*Kur përdorni ose citoni të dhënat e përfshira në këtë botim, ju lutemi tregoni burimin*”. Simboli i të drejtave të autorit duhet gjithashtu të shoqërojë të gjitha botimet e INSTAT. Përdoruesit mund të bëjnë kopje të botimeve statistikore për përdorimin e tyre, por kopje të tilla nuk mund të përdoren për ndonjë përfitim tregtar. Referencia duhet t'i bëhet gjithmonë INSTAT-it, sa herë që të dhënat e INSTAT-it përdoren publikisht.

### Referuar burimit të të dhënave

Çdo botim i INSTAT-it, çfarëdolloj forme të jetë, e shtypur apo elektronike, duhet të përmbajë listën e burimeve që mbulojnë të gjithë të dhënat e referuara në tekst ose tabela. Kur INSTAT-i përdor të dhënat e mbledhura dhe të prodhua nga organizata të tjera, referencat e burimit të të dhënave duhet të përfshihen në rezultatin përfundimtar (botim, bazën e të dhënave, etj.).

Nëse të dhënat vijnë nga një burim që nuk përfshihet në Programin e Statistikave Zyrtare (p.sh. Eurostat, etj.), referencia/burimi duhet të shtohet pikërisht nën tabelën / figurën / hartën përkatëse. Nëse një figurë përmban bashkërisht të dhëna të jashtme (p.sh. të dhënat e Eurostat) dhe të dhënat e INSTAT, atëherë duhet të përfshihet edhe burimi nga INSTAT. Kurdo që publikohen statistika, udhëzime të përgjithshme jepen se si duhet t'i referoheni Statistikave Zyrtare të Shqipërisë.

Në botimet e shtypura, udhëzimet duhet të shtypen si pjesë e botimit nën titullin, për shembull, “Referuar të dhënave në këto statistika”. Në publikimet në internet, duhet të vendoset në faqen kryesore të statistikave një link që të çon tek udhëzimet. Referencia duhet të bëhet kryesisht për publikimet elektronike të statistikave pasi ato përditësohen rregullisht dhe çdo gabim korrigjohet. Referencia kryesore në të gjitha referencat duhet të jetë Statistikat Zyrtare të Shqipërisë. Në varësi të burimit për të cilin bëhet referencia, adresa e URL-së duhet të çojë ose tek portal i INSTAT-it ose në faqen e internetit të prodhuesit (referencë për një grup të caktuar statistikash ose një pjesë të saj). Për të gjitha shembujt si dhe detyrimet e institucioneve të tjera lidhur me këto rregulla ju lutem referohu : **Aneks I - Rregulla për citimin dhe përdorimin korrekt të të dhënave statistikore nga INSTAT.**

### Palët e interesuara të statistikave

Palët e interesuara të INSTAT-it përfshijnë të gjitha grupet, entitetet dhe individët që bashkëveprojnë me statistikat në kapacitete dhe intensitete të ndryshme. Meqenëse përdoruesit e statistikave janë kategoria kryesore e përfituesve, në fokusin e të gjitha aktivitetave statistikore të institucionit, INSTAT kryen çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve. Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve është një mjet i rëndësishëm për të konstatuar nevojat e përdoruesve dhe integruar potencialisht reagimet e tyre aty ku është e mundur me procesin e planifikimit të statistikave zyrtare. Matja e kënaqësisë bazohet në modelin American Customer Satisfaction Index (ACSI). Në qendër të modelit përdoret

## POLITIKA E SHPËRNDARJES SË INFORMACIONIT STATISTIKOR

kënaqësia e përgjithshme e përdoruesve. 5 kriteret e mëposhtme merren si variabla që ndikojnë në kënaqësinë e përgjithshme të përdoruesve të INSTAT:

1. Kënaqësia me punonjësit
2. Kënaqësia me të dhënat
3. Kënaqësia me faqen e internetit
4. Kënaqësia me cilësinë e të dhënave dhe shërbimet
5. Besimi - INSTAT ka të dhëna të besueshme.

### Përdoruesit

Përmes anketës së Kënaqësisë së Përdoruesve mblidhet informacion i dobishëm lidhur me përdoruesi e INSTAT si edhe përmirësimet e mëtejshme, në mënyrë që të arrihen ato çka përdoruesit kërkojnë. Anketa realizohet mbi të dhënat e përdoruesve që kanë kërkuar statistika pranë INSTAT, duke u kombinuar edhe me pyetësorin online. Çdo vit bazuar në këtë anketë identifikohen karakteristikat demografike të përdoruesve si edhe grupet më të mëdhenj të përdoruesve që i përgjigjen pyetësorit.

### Prodhuesit

Agjencitë statistikore përfshijnë edhe Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ku marrëdhëniet dhe bashkëpunimet janë përmirësuar, edhe pse mbetet ende nevoja për përditësim dhe përmirësim të infrastrukturës dhe më shumë sinergji. Marrëdhëniet në përgjithësi me organet administrative kanë përcaktuar praktikat e shpërndarjes së të dhënave.

Sidoqoftë, nevojiten përmirësime në standartet e tyre të prodhimit të të dhënave, për të cilat INSTAT-i ka organizuar trajnime dhe seminare me mbështetjen e bashkëpunëtorëve të ndryshëm, dhe do të vazhdojë ta mbajë këtë fokus në strategjinë e tij të angazhimit me palët e interesuara. Gjithashtu, për të përmirësuar marrëdhëniet e tyre apo për të lehtësuar ligjet dhe rregulloret që mund të pengojnë praktika të caktuara statistikore dhe procedurat e shkëmbimit të të dhënave dhe informacionit, INSTAT-i ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi (Memorandum Mirëkuptimi) me palët kryesore të interesit, të tillë si prodhuesit e statistikave zyrtare, ofruesit e të dhënave administrative, botën akademike, universitete publike/private brenda vendit, si dhe edhe agjencitë statistikore apo organizata jashtë vendit.

Më poshtë jepet lista e MoU-ve ne fuqi ndërmjet INSTAT dhe institucioneve/organizatave si:

- AP - Avokati i Popullit
- AKKSHI - Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
- QKB - Qëndra Kombëtare e Bisnesit
- SHGJSH - Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
- MK- Ministria e Kulturës

## POLITIKA E SHPËRNDARJES SË INFORMACIONIT STATISTIKOR

- MASR - Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- ISSH - Instituti i Sigurimeve Shoqërore
- SHKP - Shërbimi Kombëtar i Punësimit
- SHSSH - Shërbimi Social Shtetëror
- MM - Ministria e Mbrojtjes
- DPPSH - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
- AKBN- Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore
- DPSHTRR - Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor
- AZHT - Agjencia e Zhvillimit të Territorit
- AKEP - Agjensia Kombëtare Elektronike dhe Postare
- FSDKSH- Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
- AMF- Autoriteti Mbikqyrjes Financiare
- ISHP- Instituti i Shëndetit Publik
- MSHMS - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- DPB - Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
- MB - Ministria e Puneve te Brendshme
- MBZHR - Ministria e Bujqësise dhe Zhvillimit Rural
- DPT- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
- BSH-MFE - Banka e Shqipërise dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- BSH - Banka e Shqipërisë
- PP - Prokuroria e Përgjithshme
- FEUT - Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
- MD - Ministria e Drejtësisë
- ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës
- DPGJC - Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
- SHLJP Mesdhetar - Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
- UNICEF – Organizata e Kombeve të Bashkuara pë Fondin e Emergjencës së Fëmijëve
- UT- Universiteti i Tiranës
- MAKSTAT - Enti shtetëror i Statistikave të Maqedonisë së Veriut

Megjithatë, INSTAT synon ta zgjerojë fushën e bashkëpunimit edhe me institucione të tjera dhe në këtë kuadër janë në proces përgatitje/nënshkrimi një sërë memorandumesh mirëkuptimi.

INSTAT në rolin e koordinatorit të Sistemit Kombëtar Statistikor siguron që të gjithë prodhuesit e statistikave zyrtare të përdorin standarde, konceptet, përkufizimet, klasifikimet dhe metodologjitet statistikore të miratuara nga Kombet e Bashkuara dhe Eurostat-i, si dhe koordinon programimin dhe raportimin statistikor, monitorimin të cilësisë, metodologjive, transmetimit të të dhënave dhe komunikimit mbi veprimtaritë e SKS për të gjithë vendin.

## POLITIKA E SHPËRNDARJES SË INFORMACIONIT STATISTIKOR

### Palët e interesuara të brendshme

“Audienca” e brendshme e INSTAT është gjithashtu një palë kryesore e interesit pasi institucioni është rritur me 236 pozicione në strukturën e tij. Struktura aktualisht përmban 3 drejtori të Përgjithshme (Drejtoria e Përgjithshme e Prodhimit Statistikor, Drejtoria e Përgjithshme e Teknologjisë së Informacionit dhe Mbledhjes së të Dhënavë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit), 10 drejtori (Drejtoria e Llogarive Kombëtare, Drejtoria e Statistikave Ekonomike, Drejtoria e Statistikave Sociale, Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, Drejtoria e Statistikave të Sektorit Real, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, Drejtoria e Statistikave Rajonale dhe GIS, Drejtoria e Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore, Drejtoria e Financës dhe Projekteve, Drejtoria e Komunikimit dhe Publikimeve) dhe 2 sektorë (Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integrimit Evropian dhe Sektori i Auditit të Brendshëm.

### Reagimi dhe matja e rezultateve

Rezultatet duhet të maten përmes mjeteve të ndryshme, duke iu referuar qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në strategjinë e shpërndarjes dhe planin vjetor operacional, që prodhohet në një raport vjetor të aktiviteteve të Drejtorisë së Komunikimit dhe Publikimeve. Instrumentët e mëposhtëm do të përdoren si matës kryesorë të suksesit:

**Anketa e Kënaqësisë** - Anketë Vjetore të Kënaqësisë me përdorues të jashtëm dhe stafin e brendshëm të INSTAT

**Publikimet** - Matje të prodhimit sasior dhe cilësor të botimeve/publikimeve statistikore

**Angazhimi i palëve të interesuara** - Matje sasiore dhe cilësore të aktiviteteve

**Marrëdhëniet me median** - Matje sasiore dhe cilësore të rritjes pozitive të reklamimit

**Shërbimi ndaj Klientit** - Matje sasiore dhe cilësore të aktiviteteve për kërkesa nga databaza

### Produktet dhe shërbimet që ofrohen

#### Të dhënat bazë

#### Tabelat e paracaktuara

Tabelat e paracaktuara përbajnjë të dhënat bazë rrëth fushave të subjektit. Tabelat bazohen në tabelat e publikuara në Databazën Statistikore dhe përbajnjë kodin unik të tabelës korresponduese në databazë. Tabelat e paracaktuara përditësohen automatikisht me përditësimin e të dhënavët në Databazën Statistikore.

## POLITIKA E SHPËRNDARJES SË INFORMACIONIT STATISTIKOR

### Produktet dhe shërbimet standarde

#### Databaza Statistikore

Qëllimi i Databazës Statistikore është të paraqesë të gjitha statistikat zyrtare që janë publikuar. Databaza është e disponueshme në faqen zyrtare të INSTAT, pa pagesë, dhe përditësohet vazhdimesht. Përpos statistikave të reja, databaza përfshin të dhëna për periudha të mëparshme dhe të gjitha seritë kohorë të disponueshme. Databaza publikohet në shqip dhe anglisht.

Databaza Statistikore i jep mundësi përdoruesve të përzgjedhin elementët e tabelës dhe të përcaktojnë indikatorët e dëshiruar. Tabelat ose të dhënat e përcaktuara mund të shihen(në dy opsione) në ekran ose të shkarkohen dhe ruhen në formate të ndryshme.

#### Publikimet statistikore

Çdo vit, gjatë periudhës së përpilimit të kalendarit të publikimeve, Drejtoria e Komunikimit dhe Publikimeve përcakton specifikimet e printimeve për publikimet që duhen printuar, duke marrë në kosideratë eksperiencën e viteve të kaluara dhe fushatat e planifikuara promovuese. Specifikimet e printimeve shërbejnë si bazë për përllogaritjen e kostove dhe cmimet e publikimeve. Version elektronik i të gjitha publikimeve është i disponueshëm në faqen zyrtare të INSTAT pa pagesë në orën 11:00 të mëngjesit të ditës së publikimit sipas kalendarit, në seksionin "Publikimet". Për të marrë një njoftim me e-mail rrëth daljes së publikimeve, nevojitet një regjistrim në faqen zyrtare, për të gjithë përdoruesit e interesuar. Botimet në formë libri mund të porositen online, nëpërmjet e-mailit ose telefonit. Përdoruesit mund të porositin një botim të vetëm, të bëjnë abonim vjetor ose të vazhdueshëm. Abonimet që bëhen një herë janë të disponueshme për botimet vjetore dhe botimet e tjera, dhe për publikimet që dalin një herë. Abonimet vjetore janë të disponueshme për të gjitha publikimet. Porositë e vazhdueshme janë të disponueshme për të gjitha publikimet që printohen rregullisht; porosia është e vlefshme deri kur përdoruesi vendos të ndërpresë abonimin. Menjëherë sa po merr porosinë për një publikim, INSTAT llogarit koston dhe i dërgon klientit faturën.

#### Aplikacioni i hartës statistikore

Aplikacioni i hartës statistikor është një mjet interaktiv, i cili paraqet të dhëna statistikore të gjeoreferuara. Ky Aplikacion mundëson përzgjedhjen dhe vizualizimin e të dhënave statistikore në tre nivele gjeografike: njësi vendore, qark dhe rrjeti i qelizave  $1\text{km}^2$ . Aplikacioni i hartës kryesisht përmban të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave, por përfshin gjithashtu statistika që lidhen me mjedisin, ekonominë dhe jetën sociale.

Aplikacioni i hartës mund të përdoret për të krijuar harta tematike dhe mundëson shkarkimin dhe printimin e hartës tematike nga përdoruesit.

## POLITIKA E SHPËRNDARJES SË INFORMACIONIT STATISTIKOR

### Informacione të detajuara

Përdoruesit e informacioneve të detajuara janë përdoruesit e parë dhe më kyçë, janë ata që kërkojnë statistika për të planifikuar zhvillime të ardhshme, që përgatisin projeksione etj. Përdoruesit kyçë janë përfaqësues të interest publik, të cilët gjithashtu marrin pjesë në përgatitjen e programit statistikor. Përfaqësuesit e interest publik (kryesisht ministritë dhe shoqëritë profesionale) sigurohen që të merren statistika cilësore në terren, të cilat nevojiten për të përmirësuar jetën në Shqipëri dhe për të marrë vendime në nivel kombëtar. Ata e gjejnë informacionin e detajuar të kërkuar në produkte të ndryshme, duke kombinuar të dhënat sipas nevojave të tyre specifike.

### Mikrodatat

Mikrodatat janë të dhëna të detajuara anonime, të cilat karakterizojnë një njësi specifike statistikore. Mikrodatat përdoren kryesisht nga kërkuesit shkencorë. Përdorimi i mikrodatave udhëhiqet nga Ligji Nr. 17, data 05.04.2018 "Për Statistikat Zyrtare".

Të dhënat mund të përdoren për qëllime shkencore (Neni 31 i Ligjit "Për Statistikat Zyrtare") dhe referuar Rregullores së Aksesit në të dhënat Mikro, ato mund të aksesohen në dhomën e sigurt, që ndodhet në godinën e INSTAT apo nëpërmjet sistemit të aksesimit remote (SIMONA).

### Shërbimet që ofrohen nga INSTAT

#### Kërkesa për informacion dhe/ose porosi të botimeve

Kërkesa për informacion është një lloj aplikimi që përdoret për të marrë një publikim apo një informacion të dokumentuar. Informacioni jepet si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë angleze. Nëpërmjet një kërkese për informacion, përdoruesit mund të pyesin për statistika zyrtare të publikuara më parë dhe për informacion në lidhje me INSTAT-in dhe aktivitetet e tij, apo për informacione më të detajuara sesa ato të publikuara në databazën statistikore.

Përdoruesit mund të marrin gjithashtu ndihmë për gjetjen e informacioneve që gjenden në faqet zyrtare të INSTAT-it dhe Eurostatit. Kërkesat për informacion mund t'i drejtohen INSTAT-it nëpërmjet tre kanaleve të komunikimit: Kërkesa fizike të protokolluara, e-mail dhe telefon. Kërkesat për informacion zakonisht marrin përgjigje brenda 5 ditëve të punës dhe shërbimi është pa pagesë. Kërkesat që kryhen nga gazetarët kanë prioritet (marrin përgjigje brenda 24 orëve, si rregull) për shkak të natyrës së punës që kanë.

#### Përdorimi i mikrodatave anonime për qëllime shkencore në dhomën e sigurisë në INSTAT

Bështetur në nenin 12. Aksesimi i të dhënavëve, të Rregullores së Aksesit në të dhënat Mikro, ka dy mënyra për aksesimin e të dhënavëve:

1. On-site:

## POLITIKA E SHPËRNDARJES SË INFORMACIONIT STATISTIKOR

- Të dhënat mund të aksesohen në dhomën e sigurtë në INSTAT të ndërtuar për këtë qëllim. Në kompjuterat e vendosur aty, janë të instaluar SPSS, SAS dhe R për përpunimin e të dhënavë.
- Në rastin e aksesimit në dhomën e sigurt, kërkuesve do u vihet në dispozicion dokumenti me udhëzime për përdorimin e “Dhomës së sigurtë”. INSTAT rezervon të drejtën për të kontrolluar kërkuesin shkencor gjatë punës në dhomën e sigurt pranë INSTAT, pa njoftim paraprak, për të siguruar që janë zbatuar procedurat e duhura për të mbrojtur konfidencialitetin e të dhënavë.
- Regjistrimi, kopjimi ose përpjekja për të transferuar të dhëna në çdo format nga kompjuteri i caktuar për këtë qëllim është repta si i ndaluar.

### 2. Statistical Microdata Online Access (SIMONA):

- Përdoruesit e SIMONA-s punojnë në mjedis Windows nëpërmjet lidhjes remote. Të dhënat mikro që bëhen të disponueshme mund të procesohen duke përdorur software falas si R, PSPP, Libre Office, BlueSky, Wordpad dhe QGis.
- Kërkuesve u vihet në dispozicion një manual për hyrjen dhe përdorimin e sistemit.
- Regjistrimi, kopjimi ose transferimi në kompjuterat personalë nuk është i mundur. Të dhënat procesohen në sistemin SIMONA dhe vetëm rezultatet e grupuara dërgohen me email nga INSTAT sipas parashikimeve të nenit 14.

### Aksesi në distancë

Personat fizikë e juridikë mund të aksesojnë të dhënat mikro të INSTAT-it në përputhje me legjislacionin për statistikat zyrtare edhe përmes sistemit të aksesimit remote (SIMONA). Ky shërbim është subjekt i të njëjtave terma dhe kushte si në përdorimin e të dhënavë konfidenciale në dhomën e sigurisë.

### Personat që japid të dhënat e tyre, kanë të drejtën e aksesit për të parë të dhënat që u përkasin atyre

Në mbështetje të legjislacionit për statistikat zyrtare, personat që i kanë dhënë informacionin prodhuesve të statistikave për qëllime të prodhimit të statistikave zyrtare, kanë të drejtë të aksesojnë, kundrejt asnjë pagese, të dhënat që kanë të bëjnë me ata vetë.

Për të aksesuar këto të dhëna, personi ligjor duhet të dorëzojë një kërkësë me shkrim duke specifikuar për cilat të dhëna është i interesuar. Më e shumta, brenda 5 ditëve të punës, INSTAT do të informojë personin e interesuar se kur dhe ku mund të aksesojë të dhënat e kërkuar. Informacione të mëtejshme mbi këtë shërbim duhet të jepet nëpërmjet faqes zyrtare.

## Abonimi i përdoruesit

Për t'u abonuar në grupin e përdoruesve të INSTAT, gjithkush mund të regjistrohet në sektionin e regjistrimit në faqen zyrtare të INSTAT. Përdoruesit mund të regjistrohen për të marrë elektronikisht publikimet në kohën që ato publikohen.

## Shtyllat e komunikimit për promovimin e statistikave zyrtare

Tashmë është përgatitur një Strategji e Komunikimit dhe Shpërndarjes së Informacionit, ku janë përcaktuar objektivat që duhen arritur, duke mundësuar një strukturim të rishikuar me qasje dhe aktivitete të reja dhe ekzistuese, të cilat kanë ngritur një hartë me shtyllat e komunikimit si kanalet për shpërndarjen dhe si udhëzues për përbajtjen që duhet të përbushë këto kanale. Plani vjetor Operacional dhe pjesa strategjike brenda Programit të Statistikave Zyrtare mundësojnë hapat vjetorë që duhen marrë drejt implementimit për një strategji afatgjatë.

Strategja e Komunikimit dhe Shpërndarjes së Informacionit është ndërtuar mbi 6 shtylla të forta komunikimi: Publikimet, Marrëdhëniet me Median dhe Publiciteti, Media Dixinale, Angazhimi me palët e interesuara, Komunikimi i Brendshëm (Intraneti) dhe Platforma e Brandit. Duke u mbështetur në këto shtylla të komunikimit, fushatat e mirëplanifikuara do të zbatohen rrëth produkteve dhe ngjarjeve kyçë të INSTAT.

## Publikimet

Publikimi i produkteve të INSTAT ndahet sipas natyrës së tyre në produkte mujore, tremujore, gjysmëvjetore dhe vjetore.

Në fokus të ndërtimit të publikimeve eficiente, do të jenë si më poshtë:

Në fokus të ndërtimit të publikimeve eficiente, do të jenë si më poshtë:

- Përmirësimi i paraqitjes vizuale të publikimeve dhe prezantimi i përbajtjes
- Krijimi i fushatave për publikime të rëndësishme
- Promovimi nëpërmjet rrjeteve sociale
- Promovimi nëpërmjet grafikëve inovativë dhe vizualizim të thjeshtuar
- Revistë të re Shkencore në bashkëpunim me kërkues shkencorë

## Marrëdhëniet me Median dhe Publiciteti

Media luan një rol kyç pasi shërben në një mori rolesh. Në shpërndarjen e stastistikave, media është një target i rëndësishëm i publikut, po ashtu është edhe një kanal për grupe të tjera të synuarish. Pra, në vetvete është një ndikues i fuqishëm, një zë që mbërrin në publikun e gjerë dhe një përdorues i madh i produkteve statistikore. Kështu, në një marrëdhënie kaq komplekse, integrimi i veprimeve të ndryshme për të ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme me median,

## POLITIKA E SHPËRNDARJES SË INFORMACIONIT STATISTIKOR

është e dëmshme për arritjen e disa synimeve në të njëjtën kohë. Strategjia fokusohet në 4 shtylla kryesore të aktiviteteve, duke u bazuar se cilin nga përmbajtjet e strategjisë formulojmë për përmirësimin e mbulimit mediatik dhe publicitetin e vazhdueshëm optimal: Njoftimin për shtyp, Konferencën për shtyp, Artikuj dhe Intervista dhe aktivitete Mediatike.

### Njoftime për shtyp

Njoftimi për shtyp është një pjesë informacioni në formën e shkrimit për shtyp, ku prezantohet një pjesë e statistikave që janë prodhuar së fundmi. Njoftimet për shtyp vënë publikun në dijeni mbi të dhënat e plota dhe të reja të disponueshme në një fushë të caktuar të statistikave. Njoftime të ndara për shtyp publikohen për të vënë publikun në dijeni mbi konferencat e organizuara nga INSTAT apo për evenete të tjera më të mëdha. Njoftimet për shtyp publikohen në faqen zyrtare të INSTAT dhe i dërgohen gazetarëve me e-mail. Njoftimet statistikore bazohen vetëm mbi gjetjet dhe rezultatet statistikore duke ndjekur eksperiencën dhe praktikat më të mira nga shtetet e tjera. Sipas Ligjit për Statistikat, Statistikat Zyrta do të japid informacione sasiore dhe përfaqësuese për publikun e përgjithshëm, parlamentin, qeverinë, autoritetet e tjera publike, ekonomike, biznesin dhe organizatat shoqërore, institucionet akademike dhe kërkimore, dhe median kombëtare dhe ndërkontinentale. Ato do të reflektojnë situatën reale dhe do të shpërndajnë rezultatet në mënyrë të paanshme. Autoritetet qeveritare dhe grupet e tjera të përmendura në Ligjin “Për Statistikat Zyrta” respektojnë parimet që janë vendosur në këtë ligj dhe këto autoritete nuk lejohet të influencojnë stafin e agjencisë statistikorë në përformacën e detyrave të tyre.

Koka e fajes duhet të përmbajë këto:

- Logon e INSTAT; titullin e dokumentit “Njoftim për Media”
- Nëntitullin e dokumentit si p.sh “Indikatorët Demografikë”
- Numrin dhe datën e njoftimit

Fundi i fajes duhet të përmbajë si më poshtë:

- Një deklaratë, p.sh, “INSTAT është një institucion i pavarur publik, koordinatori zyrtar i Sistemit Kombëtar të Statistikave në Shqipëri, që mundëson informacion statistikor transparent, neutral, në kohë, relevant, të besueshëm për të gjithë vendimmarrësit, kërkuesit dhe arsimin në Shqipëri, po ashtu edhe për komunitetin ndërkombëtar.
- Seksioni “Për më shumë informacion” me informacion mbi të dhënat e kontaktit dhe linkun që të çon në të dhënat e publikimit.

### Media Dixhitale

INSTAT ka bërë progres në aspektin e prezencës së saj në mediat dixhitale, përmes lançimit të suksesshëm të faqes së re të internetit në vitin 2017, dhe duke u bërë aktive në Facebook, si një nga mediat sociale më populllore në Shqipëri. Për të vazhduar me këtë progres, qasja dixhitale do të përqendrohet në 4 shtyllat kryesore që përcaktojnë:

#### Kanalet për të përcjellë mesazhet tona:

- Faqja e internetit të INSTAT
  - Facebook-u
  - Kanali i YouTube-it
  - Media të tjera që do të merren parasysh në vitet e ardhshme, Twitter, LinkedIn, Instagram.
- 
- ✓ Markimi dhe strukturimi i kanaleve me logon e INSTAT
  - ✓ Ndërtimin Editorial
  - ✓ Promovimin e përbajtjes në mënyrë të përshtatshme

Ndërtimi i kanaleve dixhitale të vetë INSTAT është hapi i parë i rëndësishëm për të pasur informacionin të gatshëm dhe të disponueshëm për të gjithë përdoruesit dhe me qasjen e duhur; audiencia tërhiqet nga informacioni.

### Angazhimi i palëve të interesuara

Në një vend ku statistikat nuk janë as një pjesë specifike e fokusit akademik, nuk është çudi që statistikat kuptohen pak nga shumica. Një qasje e tillë specifike duhet të përdoret për të adresuar rritjen e njohurive dhe të kuptuarit të statistikave nga të gjithë përdoruesit. Instrumente të ndryshme janë zgjedhur për grupe të ndryshme të synuara. Aktivitetet specifike me palët e interesuara për promovimin e logos dhe produktit mund të organizohen në një kalendar aktivitetesh për t'u mbajtur në Sallën e re të Trajnimit:

- ✓ Forumë të njohurive
- ✓ Tryeza të rrumbullakëta
- ✓ Seminare & Workshop
- ✓ Panaire & Ekspozita

## Aneks I

### Rregulla për citimin dhe përdorimin korrekt të të dhënave statistikore nga INSTAT

Ky aneks është pjesë integrale e Politikës së Shpërndarjes së Informacionit Statistikor të INSTAT dhe ka për qëllim të saktësojë mënyrën e citimit dhe komunikimit të statistikave zyrtare nga përdoruesit institucionalë dhe publikë.

#### 1. Citimi i detyrueshëm i burimit

Të gjitha të dhënat statistikore të produara dhe publikuara nga INSTAT duhet të shoqërohen me citimin korrekt të burimit në çdo formë ripërdorimi, qoftë në:

- Publikime shkencore apo institucionale,
- Strategji dhe dokumente politike,
- Prezantime zyrtare,
- Raporte ndërkombëtare,
- Media, rrjete sociale apo portale të informimit publik.

**Forma standarde e citimit është:**

**Burimi: INSTAT – Instituti i Statistikave, [titulli i publikimit/statistikës], [data ose viti].**

#### 2. Ripërdorimi i të dhënave nga burime ndërkombëtare

Kur të dhënat statistikore janë të marra nga platforma ndërkombëtare (p.sh. Eurostat, OECD, UNStats etj), përdoruesit duhet të bëjnë dallimin midis:

- **Burimit të publikimit** (institucioni që i ka publikuar të dhënat) dhe
- **Burimit origjinal të të dhënave** (institucioni që i ka prodhuar).

Në rastet kur të dhënat e Eurostat janë raportuar nga INSTAT, duhet të përmendet:

**Burimi: Eurostat (të dhëna të raportuara nga INSTAT).**

Kjo ndihmon në ruajtjen e integritetit të burimit dhe shmang keqinterpretimet që mund të lënë të kuptohet se shifrat janë të produara nga një institucion i huaj.

#### 3. Ndryshimet dhe përpunimet dytësore

Nëse të dhënat statistikore të INSTAT përpunohen, agregohen, interpretohen ose vizualizohen nga institucione të tjera, kjo duhet të shoqërohet me një shënim që bën të qartë përpunimin e bërë:

**Përpunim dhe vizualizim: Institucioni X, bazuar në të dhëna nga INSTAT.**

#### **4. Përgjegjësia për interpretim**

*INSTAT nuk mban përgjegjësi për interpretimet e bëra nga përdoruesit institucionalë apo individualë të të dhënave statistikore të publikuara. Çdo përfundim, koment, apo rekomandim që del nga përdorimi i të dhënave të INSTAT mbetet në përgjegjësi të plotë të institucionit ose individit që e ka bërë atë.*

#### **5. Kërkesa për sqarim**

Në rast pasigurie mbi burimin ose mënyrën e raportimit të një të dhëne, përdoruesit janë të ftuar të kontaktojnë zyrtarisht me INSTAT për sqarime përpëra se të bëjnë publikimin.